

## **Cikli I programeve: “PERMES BIBLES”**

### **Emisioni nr 699 Filipianët 4**

#### **Kapitulli 2**

Tema: Modeli i jetës së krishterë – të tjerët; mendja e Krishtit-përlulja; mendja e Zotit – lartësimi i Krishtit; mendja e Palit – gjërat e Krishtit; mendja e Timoteut – në një mendje me Palin; mendja e Epafroditit – puna e Krishtit.

Në kapitullin e parë pamë filozofinë e jetës së krishterë të përmbledhur në një varg: “Për mua të jetuarit është Krishti dhe të vdekurit është fitim.” Krishti ishte qendra e jetës së Palit. Në këtë kapitull do të shohim modelin e jetës së krishterë, që është mendja e Krishtit.

Kjo nuk mund të bëhet me anë të imitimit. Dëgjoj njerëz që flasin për ndjekjen e Jezusit. Ndonjëherë kam dashur t’i pyes këta njerëz se çfarë duan të thonë me këtë, sidomos atëherë kur jetët e tyre nuk përshatën me atë që thonë. A po përpiqen ata të imitojnë Jezusin? Kur Pali tha që Krishti është modeli për jetën e krishterë, nuk e ka fjalën për imitim. Përkundrazi Ai po flet për komunikim. Kjo do të thotë që mendja e Krishtit duhet të jetë në ne dhe kjo mund të ndodhë vetëm nëpërmjet fuqisë së Frymës së Zotit.

Para disa kohësh kam mësuar se kur i bëj gjërat me mendjen time, ato jo vetëm që nuk bëhen mirë, por edhe janë gjithmonë gabim. Kështu akuzohem se jam një person me vullnet të fortë dhe se kam prirjen të eci përpara me vullnetin tim. Por, kur veproj kështu, kafshoj gishtin dhe them: “Zot, jam gati që ta marrësh Ti pushtetin në dorë.” Ka qenë e mrekullueshme për mua të shoh se si merr Zoti kontroll mbi situatën.

Ne duhet të mësojmë të ulemi dhe të shikojmë sesi lëviz Fryma e Zotit. Kjo nuk do të thotë që duhet të ulemi dhe të rrimë duar lidhur. Sigurisht ne zbatojmë programin që na ka dhënë Zoti të bëjmë, por fuqia dhe forca vjen vetëm nga Fryma e Zotit.

Në këtë kapitull bëhet një nga deklaratat teologjike më të mëdha në Shkrim në lidhje me personin e Krishtit. Përgjatë shekujve një nga çështjet më të diskutueshme ka dalë nga ajo deklaratë teologjike. Në fakt, kjo gjë, që me shumë mundësi e ndau Evropën, ka të bëjë me

të, më shumë se me gjithcka tjetër. Teoria e përkrahur ishte teoria *kenosis*, që do të thotë se në mishërimin e Krishtit Ai e zbrazi Vetën nga hyjnia e Tij. Ky kapitull bën të qartë se Ai nuk e zbrazi Vetën e Vet nga Hyjnia e Tij.

## **MODELI PËR JETËN E KRISHTERË – TË TJERËT**

Para se të arrijmë tek çështja e diskutueshme, le të vëmë re anën praktike – kjo është një letër praktike.

**“Pra, në qoftë se ka ndonjë ngushëllim në Krisht, ndonjë ngushëllim dashurie, ndonjë pjesëmarrje të Frymës, ndonjë mallëngjim e dhembshuri,” [Fil. 2:1].**

Fjala “në qoftë se” që fillon këtë varg nuk është një “në qoftë se” kushtore. Ky nuk është një artikull kushtor. Ju do të zbuloni se Pali përdor artikullin “në qoftë se” si një argument më tepër se një kusht. Pali është një mendues llogjik. Thuhet se nëse nuk e shihni që Pali është një person llogjik, atëherë ju nuk po e lexoni atë sic duhet. Përkthimi më i saktë do të ishte: “Meqënëse ka një ngushëllim në Krishtin, një ngushëllim dashurie, një pjesëmarrje të Frymës, një mallëngjim e dhembshuri.”

Vini re se çfarë thotë Pali:

**“atëherë e bëni të plotë gëzimin tim, duke pasur të njëjtin mendim, të njëjtën dashuri, një unanimitet dhe një mendje të vetme.” [Fil. 2:2].**

Edhe pse ai është në burg, ai gëzohet në Zotin, por ai thotë se ai do të gëzohej më shumë nëse do ta dinte që ungjilli po punonte në jetën e besimtarëve filipianë.

“duke pasur të njëjtin mendim, të njëjtën dashuri, një unanimitet dhe një mendje të vetme.” E shihni, ashtu si e vumë re edhe më parë, në kishën filipinase kishte pasur vështirësi të vogla – jo të mëdha, por të vogla. Pali dëshiron që ata të jenë në një mendje.

Ai nuk po i thotë atyre të jenë kopje karboni të njëri-tjetrit. Në shumicën e kishave ekzistojnë dy grupe njerëzish: njëri grup është pro pastorit dhe grupi tjetër është kundër tij. Njerëzit që përbëjnë këta grupe nuk kanë një mendim të tyre, por ata janë kopje karboni të drejtuesit të grupit të tyre.

Të jesh në një mendje të vetme do të thotë ta lejosh mendjen e Krishtit të jetë në ty. Kjo lejon ndryshime në shprehje, ndryshime në dhurata, ndryshime në metodat e shërbimit, madje edhe ndryshime në doktrina të vogla. Ne nuk do të rrihemi me njëri-tjetrin për shkak se nuk biem dakort për këto gjëra. Por, nëse kemi mendjen e Krishtit, do të biem dakort në parimet kryesore të besimit.

**“Mos bëni asgjë për rivalitet as për mendjemadhësi, por me përulësi, secili ta çmojë tjetrin më shumë se vetveten.” [Fil. 2:3].**

Besoj se e mbani mend që Pali e përmendi këtë gjë edhe më parë. Ai tha se disa njerëz e predikonin Krishtin nga smira dhe nga grindjet. Ndërsa tani ai thotë: “Mos bëni asgjë për rivalitet, as për mendjemadhësi.” Unë mund të them se vështirësitë më të mëdha në kisha sot nuk janë për shkak të ndryshimeve doktrinore, por për shkak të smirës dhe grindjeve. Disa njerëz shkaktojnë telashe në mënyrë të natyrshme. Nëse ne do të ndiqnim këtë udhëzim: “Mos bëni asgjë për rivalitet, as për mendjemadhësi”, atëherë mendoj se do të zgjidheshin 90, ose 100% e problemeve të kishës sot.

Nëse po bëni dicka në kishë përmes grindjes, do të ishte më mirë të mos e bënit fare. E njëjta gjë është e vërtetë edhe nëse bëni gjëra për shkak se prisni që të vlerësoheni. Një nga arsyet se përse nuk më pëlqen të organizoj takime është sepse lodhem nga njerëzit që duhet të falenderojnë zonjën filan sepse ajo solli një buqetë me lule ose zotin filan sepse ai solli një karrige tepër – dhe ti nuk duhet të harrosh asnjë sepse përndryshe do ta gjesh veten në telashe. A duhet të lavdërohen, vlerësohen dhe komplimentohen të krishterët për punët që bëjnë? “Asgjë të mos bëhet për rivalitet dhe as për mendjemadhësi” – duke u përpjekur të mos ngrini emrin tuaj lart. “Por me përulësi secili ta çmojë tjetrin më shumë se veten.” Ndoshta ky ishte problemi midis Evodisë dhe Sintikës. Ndoshta secila prej tyre mund të jetë ndjerë e ulur nga tjetra.

Nëse ne do t’i bindeshim këtij vargu, unë besoj se do të zgjidheshin problemet në shumicën e departamenteve muzikore të kishës. Kjo gjë do të eliminonte këtë qëndrim: “Përse ata nuk më thirrën mua për të kënduar? Unë kam zë më të bukur se filani.” E njëjta gjë mund të thuhet për problemet në bordet dhe komitetet. Kjo gjë do të eliminonte “betejat e fuqisë” që zhvillohen në disa kisha midis nënpunësve të tyre.

**“Mos mendojë secili për interesin e vet, por edhe atë të të tjerëve.” [Fil. 2:4].**

“Të të tjerëve”! Kjo është një fjalë e rëndësishme.

Jam befasuar shumë nga një letër që erdhi nga një tjetër spiker së bashku me një dhuratë për programin tonë. Ajo vinte nga një njeri, programi i të cilit transmetohej në të njëjtin stacion me tonin. Ai shkruante: “Programi juaj është një bekim i vërtetë.” Unë nuk dija asgjë për programin e këtij njeriu, por mund t’ju them dicka që dija për këtë person. Ai po shfaqte mendjen e Krishtit. Ai po mbarte këshillën e këtij vargu: “Mos të mendojë secili për interesin e vet, por edhe për atë të të tjerëve.” Letra e tij ishte një përvojë mjaft përulëse për mua.

“Të tjerëve” është një fjalë kyce për këtë pasazh. Besimi i krishterë e bëri fjalën “të tjerët” të rëndësishme. Përse erdhi Krishti nga lavdia e qiejve në këtë tokë? Ai erdhi për të tjerët. Përse duhet ta transmetojmë ungjillin? Për të tjerët. Të mendosh për të tjerët më shumë se për veten tënde do të thotë të kesh mendjen e Krishtit.

## **MENDJA E KRISHTIT – PËRULËSIA**

Tani, Pali na tregon dicka për mendjen e Krishtit.

**“Kini në ju po atë ndjenjë që ishte në Jezu Krishtin.” [Fil. 2:5].**

Cila është ajo gjë që karakterizon mendjen e Krishtit? Përulësia. Ju mund të kujtoni fare mirë që tek Efesianët 4 na thuhet: “... ecni denjësisht sipas thirrjes për të cilën u thirrët.” Pastaj vazhdon duke përshkruar mënyrën e ecjes: “me çdo përulësi e zemërbutësi, me durim, duke e duruar njëri-tjetrin në dashuri.” (Efes. 4:1-2). Kjo është mendja e Krishtit.

Unë dhe ti nuk mund të jemi të përulur. Ne nuk mund të jemi zemërbutë. Ne nuk jemi bërë në këtë mënyrë. Ne na pëlqen të qëndrojmë në këmbët tona dhe të themi fjalët tona. Të gjithë njerëzit janë kështu. Mos thuaj që nuk je, sepse ne të vërtetë je. Asnjërit prej nesh nuk i pëlqen të ofendohet. Asnjërit prej nesh nuk i pëlqen të injorohet. Ne zhvillojmë disa sjellje frenuese nëse jemi rritur në një ambient ku na kanë shkelur me këmbë.

Kam dëgjuar për djalin e një ministri që ishte bërë rrugac. Pse? Kjo kishte ndodhur për shkak se ai kishte një vëlla tjetër që ishte një

djalë i shkëlqyer. Ky djalë dëgjonte vazhdimisht për gjërat që vëllai i tij i shkëlqyer bënte. Kështu, që ai shkoi në drejtim krejt të kundërt duke rebeluar kundra tij. Ky është reagimi i natyrshëm i njeriut natyror. Madje nuk do t'ia vlente aspak sikur të shkoje tek ai djalë dhe t'i thoshe: “Dëgjo, bir, injoroje këtë fakt. Mos e merr fare parasysh.” Ai nuk ka për ta injoruar atë. Një person që nuk është i lindur sërish nuk është i gatshëm të zërë një vend të përlulur. Tani mbërrijmë në një nga deklaratat më të mëdha teologjike në Shkrim. Disa e quajnë atë si deklarata më e madhe doktrinale në Testamentin e Ri që ka lidhje me personin e Krishtit, dhe njihet si *kenosis*, “zbrazja”. Ky pasazh do të na bëjë të qartë që Ai nuk e zbrazti Vetën e Tij nga Hyjnia. Këtu jepen shtatë hapa përlulje që Krishti mori. Do të doja të skicoja për ju rëndësinë e asaj që thuhet në vargjet në vijim. Do të doja që të gjithë ne të kuptonim se sa i lartë ishte Ai dhe sa i përlulur erdhi këtu në tokë. Miliardat e viteve dritë përtej hapësirës së njohur nuk kanë të krahasuar me largësinë nga e cila Ai erdhi.

Ne shohim këtu shtatë hapa zbritëse. Pastaj renditen për ne edhe shtatë hapa ngjitëse, lartësimi i Krishtit. Së pari, në përlulësi ne shohim mendjen e Krishtit. Pastaj ne shohim mendjen e Zotit. Lartësimi i Zotit Jezus Krisht është në mendjen e Atit Perëndi. Nëse doni të dini se çfarë mund të bëni, kjo do t'ju vendosë në vullnetin e Zotit – unë nuk e di se për ku jeni drejtuar apo çfarë po bëni – por unë mund t'ju them këtë: meqënëse qëllimi i Atit Perëndi është të lartësojë Jezus Krishtin, unë besoj se ky është vullneti i Zotit për të gjithë ne. Ne duhet të lartësojmë Jezus Krishtin, kudo që jemi dhe në çfarëdo gjëje që bëjmë. Ne duhet të jemi një me Atin në këtë qëllim përfundimtar të lartësimit të Jezus Krishtit.

Hapi i parë poshtë ishte kur Ai la lavdinë e qiellit. Ai zbriti poshtë në këtë tokë, ku ne ishim. Unë dhe ti nuk mund ta marrim dot me mend se çfarë hapi i madh ishte të lije lavdinë e qiellit dhe të zbrisje në këtë tokë. Të kuptosh atë çfarë bëri Zoti ynë në të vërtetë për ne është përtej kuptimit njerëzor.

**“i cili, edhe pse ishte në trajtë Perëndie, nuk e çmoi si një gjë ku të mbahej fort për të qenë barabar me Perëndinë.” [Fil. 2:6].**

Më duhet të pohoj se ky është një përkthim disi i ftohtë. Kur Krishti ishte në anën e djathtë të Atit Perëndi, Ai nuk po mbahej fort tek pozita e Tij. Nuk kishte asnjë rrezik që Ai të humbiste pozitën e Tij

në Hyjninë për shkak të mungesës së Tij apo për shkak të aftësisë apo ambicjes së një konkurenti tjetër. Ai nuk kishte shkuar në shkollë për të mësuar si të ishte Zot; Ai nuk ishte ngritur në detyrë nga një pozitë tjetër. Ai ishte Perëndi. Zoti Jezus nuk i tha Atit Perëndi: “Sigurohu ta ruash vendin tim për 33 vjet që nuk do të jem këtu. Ruaje me kujdes sepse mendoj që Gabrieli do të donte të zinte vendin tim.” Nuk po tregohem pa respekt; unë po përpiqem t’ju tregoj se kjo nuk ishte dicka tek e cila Ai duhet të mbahej fort. Ajo pozitë i përkiste Atij. Ai ishte Perëndi.

Ai nuk u largua nga qielli me ngurim. Ai nuk tha asnjëherë: “Oh sa e urrej të largohem nga qielli. Nuk dua ta bëj këtë udhëtim aty poshtë në tokë.” Ai erdhi me gëzim. “... për gëzimin që ishte vendosur para tij...” (Heb. 12:2) Ai duroi kryqin. Ai tha: “...Ja, unë vij për të bërë, o Perëndi, vullnetin tënd” (Heb. 10:7). Ai erdhi në këtë tokë me gëzim. Ai nuk po hiqte dorë nga dicka që donte ta mbante fort kur erdhi këtu në tokë.

Le të shohim hapin e dytë zbritës.

**“por e zbraz veten e tij, duke marrë trajtë shërbëtori, e u bë i ngjashëm me njerëzit;” [Fil. 2:7].**

“Por Ai e zbraz veten e tij” – fjala greke këtu është *kenoo*. Teoria kenosis e merr emrin e saj nga fjala greke *kenoo*. Krishti e zbraz Vetën e Tij. Çështja është: Nga se e zbraz Ai Vetën e Tij? Disa njerëz thonë se Ai e zbraz Vetën nga Hyjnia e Tij. Të gjithë Gnostikët në kishën e hershme parashtruan herezinë e parë që Ai e zbraz Vetën nga Hyjnia e Tij dhe se hyjnia hyri tek Ai në kohën e pagëzimit dhe u largua prej Tij në kryq. Ai e zbraz Vetën e Tij nga dicka, por kjo nuk ishte hyjnia. Ai ishte 100% Perëndi, kur ishte një bebe e mbështjellë në gjoksin e Marisë. Edhe në atë kohë Ai mund të kishte folur një fjalë për ta zhdukur këtë univers, sepse ishte Perëndi. Nuk pati asnjëherë asnjë moment kur Ai nuk ishte Perëndi. Apostulli Gjon shkruan: “Në fillim ishte Fjala dhe Fjala ishte me Perëndinë dhe Fjala ishte Perëndi. Ai ishte në fillim me Perëndinë. Të gjitha gjërat u bënë me anë të Tij dhe pa atë nuk u bë asgjë nga ato që u bënë. ... Dhe Fjala u bë mish dhe banoi ndër ne ...” (Gjon. 1:1-3; 14).

Atëherë nga se e zbraz Zoti Jezus Vetën e Tij kur erdhi në këtë tokë? Unë besoj se Ai e zbraz Vetën nga privilegjet e Hyjnisë. Ai jetoi në këtë tokë me disa kufizime, por ato ishin vetë-kufizime. Nuk

pati asnjëherë asnjë moment kur Ai nuk ishte Perëndi. Ai nuk ishte më pak Perëndi sepse ishte njeri, e megjithatë Ai e zbrazi Vetën e Tij nga privilegjet e hyjnisë.

Barinjte, njerëzit e ditur dhe madje edhe turmat e ëngjëjve ishin një grup njerëzish që pritën Birin e Perëndisë kur Ai erdhi në tokë. Atje nuk duhet të kishte qenë vetëm ajo turmë, por i gjithë universi. Të gjithë krijesat inteligjente të Zotit duhet të kishin qenë atje. Hierarkia e Romës duhet të kishte qenë atje. Nuk duhet të kishte vetëm pak njerëz të ditur nga Lindja. Ata duhet të kishin ardhur nga Perëndimi, Veriu dhe Jugu. Tempulli në Jeruzalem duhet të kishte qenë bosh atë ditë, në mënyrë që të gjithë të kishin zbritur në Betlehem. Por, në fakt nuk ndodhi kështu.

Përse nuk i detyroi Ai ata të vinin? Sepse Ai i kishte lënë mënjanë privilegjet e Tij të hyjnisë. Ai ishte i gatshëm të lindte në një vend të ndotur e të pistë dhe jo në një stallë të pastër Krishtlindje që shfaqet në kartolinat e Krishtlindjes. Ai ishte i gatshëm të rritej në një qytet të mjerë të quajtur Nazaret. Ai ishte i gatshëm të ishte një marangoz i panjohur. Ai mund të kishte pasur lavdinë Shekinah gjatë gjithë kohës me vete, por nuk e bëri këtë. Ai nuk kishte një rreth të ndritshëm rreth kokës, ashtu sic e shohim në shumë piktura. Judës iu desh ta puthte natën që e tradhëtoi në mënyrë që turma të mund ta dinte se cili ishte njeriu që duhej kapur.

Ai nuk qëndroi para njerëzve me një lloj drite të brendshme, apo lavdie rreth Tij. Ai ishte një qenie njerëzore, e në të njëjtën kohë edhe Perëndia i manifestuar në mish. Ai i la mënjanë privilegjet e Tij hyjnore.

A mund të jemi të sigurtë për këtë? Unë mendoj që po. Pasi kishte mbaruar shërbesën e Tij, Ai i mbledhi të Tijët natën e fundit në këtë tokë. Ai i bëri një lutje të mrekullueshme Atit të Tij qiellor. Një nga gjërat që tha në lutje ishte: “Tani, pra, më përlëvdo, o Atë, pranë teje, me lavdinë që unë e kisha pranë teje para se të bëhej bota.” (Gjon. 17:5). Vini re me kujdes: Ai u lut që t’i kthehej lavdia. Ai nuk u lut që t’i kthehej hyjnia e Tij, sepse Ai nuk hoqi dorë kurrë nga hyjnia e Tij. Por, tani që po kthehej në qiell, Ai po kërkon që lavdia e Tij, drita e lavdisë, një privilegj i hyjnisë, të kthehej tek Ai. Me sa duket Ai e kishte lënë atë. “i cili, edhe pse ishte në trajtë Perëndie, nuk e çmoi si një gjë ku të mbahej fort për të qenë barabar me Perëndinë; por e zbrazi vetën e tij.”

Hapi i tretë poshtë në përrulësinë e Krishtit është: “Duke marrë trajtë shërbëtori”

Jezusi erdhi në këtë tokë si shërbëtor. Ai punoi si zdrukthëtar. Nëse do të kishit jetuar në Nazaret në atë kohë, me siguri mund të kishit shkuar tek dyqani ku punonte Jezusi dhe t'i thoshit se kishit nevojë për disa rregullime në shtëpinë tuaj. Si për shembull: “Dera ime ka dalë nga menteshat. Do të doja të dija nëse mund të vije që ta rregulloje atë?” Mendoj se Ai do të kishte thënë: “Do të vij menjëherë aty.” E shihni, Ai kishte marrë vendin e një shërbëtori. Ai mund të kishte lindur në pallatin e Cezarit. Edhe pse ishte mbret, Ai nuk e kërkoi këtë pretendim në atë kohë. Në fakt, Ai nuk e kërkoi atë derisa hyri në Jeruzalem në të ashtuquajturën hyrje triumfale. Ai erdhi në këtë botë si një njeri punëtor, një njeri i përlurur, një njeri i vogël. Ai jo vetëm që e përlurur Vetën për të qenë një qenie njerëzore, por edhe u bë si shumica prej nesh. Ai u bë një nga njerëzit e vegjël.

Profeti Isaia shkroi se Krishti do të vinte si “rrënja e Isaias” (shih Isaia 11:10). Kur isha predikues i ri, shpesh kam pyetur veten se përse Isaia nuk e quajti Atë një rrenjë të Davidit. Por, me kalimin e kohës kam zbuluar arsyen. Kur lindi Jezusi, Maria, që ishte në linjën e Davidit (dhe Jozefi, që ishte gjithashtu në linjën e Davidit me anë të një rruge tjetër) ishte një fshatare. Ata ishin njerëz punëtorë që jetonin në atë qytet të vogël, të varfër që quhej Nazaret. A nuk ishte Jezusi në linjën e Davidit? Oh, sigurisht që po. Davidi ishte mbreti i vajosur, por ati i tij Isaia ishte një fermer në Betlehem dhe linja e tij kishte mbetur pas në vendin e një fshatari. Zoti ynë lindi në një familje fshatare.

“Ai mori trajtë shërbëtori”